



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-04/IA006

**Vendosi:** Kryetarja e Dhomave të Specializuara  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 26 janar 2023

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

## Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

---

**Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:**

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatëse Nina Jorgensen

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të Specializuar:**

Aleks Uajting

**Mbrojtjes së Pjetër Shalës:**

Zhan-Lui Zhilisen

**Mbrojtësit të viktimave:**

Sajmon Loz

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(c) dhe 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullave 77, 169 dhe 170(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një Panel të Gjykatës së Apelit pas lëshimit prej Trupit Gjykues I të Vendimit mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala (“Vendimi i Miratimit të Lejes për Apel”).<sup>1</sup>

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 6 dhjetor 2022, Trupi Gjykues mori Vendimin në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala (“Vendimi i Kundërshtuar”).<sup>2</sup>
2. Më 13 dhjetor 2022, z. Shala kërkoi leje për apelim të Vendimit të Kundërshtuar.<sup>3</sup>
3. Më 24 janar 2023, Trupi Gjykues nxori Vendimin e Miratimit të Lejes për Apel, me anë të cilit z. Shala i miratohet pjesërisht kërkesa për apelim.<sup>4</sup>

## II. CAKTIMI

4. Pas shqyrtimit të kriterëve të përcaktuara në rregullën 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe

---

<sup>1</sup> F00401, Vendimi mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala, 24 janar 2023.

<sup>2</sup> F00364, Vendimi në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala, 6 dhjetor 2022. Versioni i korrigjuar u dorëzua më 8 dhjetor, F00364/COR.

<sup>3</sup> F00369, Mbrojtja, Kërkesë për Leje për Apelim të Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala, 13 dhjetor 2022.

<sup>4</sup> Vendimi i Miratimit të Lejes për Apel, para. 73(a).

disponueshmërisë në këtë moment,

**KRYETARJA ME KËTË VENDIM ÇAKTON:**

**Gjykatëse Mishelë Pikar**

**Gjykatës Emilio Gati**

**Gjykatëse Nina Jorgensen**

në Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur mbi apelin  
në pajtim me Vendimin e Miratimit të Lejes për Apel

/nënshkrimi/

---

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,**

E enjte, 26 janar 2023  
Hagë,  
Holandë